



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË
PËR KRIME TË RËNDA

NR. AKTI 21
27.12.2012

NR. VENDIMI 17
29.12.2012

VENDIM

“Ne emer te Republikes”

Gjykata e Shkalles se Pare
per Krime te Renda Tirane e perbere prej:

Gjyqtare : Iliriana OLLDASHI

Asistuar nga sekretari gjyqesor **Besjan Hysi**, sot ne daten **29/12/2012**, ora **10.30 ne Tirane**, mori ne shqyrtim ne seance gjyqesore kerkesen penale nr. **17** qe i perket :

Kerkues: Prokuroria prane Gjykates se Shkalles se Pare per Krime te Renda Tirane, perfaqesuar ne gjykim nga prokurori **E. K. .**

Me objekt: Sekuestrimin e pasurise.

KUNDER: **Shtetasit O. T.**, i biri i K.-os dhe i Z.-es,
i datelindjes xx/xx/xxxx, lindur ne Tirane dhe banues
ne xxxxx, Rruga “xxxxxx ”.
(Aktualisht i paraburgosur prane I.E.V.P Jordan
Misja, Tirane).

BAZA LIGJORE: **Ligji nr. 10192 date 03/12/2009** “Per Parandalimin dhe Goditjen e Krimet te Organizuar dhe Trafikimit Nepermjet Masave Parandaluese kunder Pasurise”.

Ne perfundim te shqyrtimit te kerkeses te zhvilluar ne prani te prokurorit E. K. qe kerkoi: pranimin e kerkeses, kjo gjykate pasi degjoi kerkimet dhe shqyrtoi aktet e paraqitura :

VEREN se :

Prokuroria per Krime te Renda Tirane ka paraqitur para kesaj gjykate nje kerkese per sekuestrimin e pasurise se shtetasit O. T. duke pretenduar se eshte subjekt i hetimit pasuror sipas ligjit **nr. 10192 date 03/12/2009 “Per Parandalimin dhe Goditjen e Krimet te Organizuar dhe Trafikimit Nepermjet Masave Parandaluese Kunder Pasurise”**, pasurite e zoteruara nuk i pergjigjen nivelit te te ardhurave dhe fitimeve te tij, si dhe ekziston rreziku, qe keto pasuri te humbasin, apo tjetersohen. Kerkesen prokurori e paraqet duke ju ketyre fakteve:

“ Prokuroria prane Gjykates se Shkalles se Pare per Krime te Renda Tirane me date 19/12/2012, ka regjistruar procedimin penal Nr.27, per vepren penale te parashikuar nga neni **283/a/2** i Kodit Penal ne ngarkim te te pandehurve **O. T. , D. L. etj.**

Nga hetimet e kryera, ka rezultuar se shtetasit O. T. , D. L. dhe A. C. jane implikuar ne ngjarjen e dates **09/03/2010** ku ne Gjermani eshte arrestuar shtetasi K. K. dhe ne kamionin qe ai drejtonte eshte gjetur dhe sekuestruar nje sasi lende narkotike prej 232 kg e llojit Cannabis Sativa.

Hetimet e Prokurorise per Krime te Renda kane filluar pas mberritjes se materialeve per kete ngjarje kriminale nga autoritetet gjermane te drejtesise si rezultat i te cilave eshte bere rregjistrimi i emrave te O. T. , D. L. dhe A. C. si persona te cileve ju atribohet vepra penale e “Trafikimit te narkotikeve ” e kryer ne bashkepunim e parashikuar nga neni 283/a/2 i Kodit Penal. Gjate kontrollit personal ne momentin e arrestimit, shtetasit O. T. i jane gjetur dhe sekuestruar per llogari te procedimit penal nje shume monetare prej 10.490 euro dhe 10.600 leke te cilat jane depozituar ne Banken Intesa San Paolo me nr. Llogarie 2021930701 dhe ne Banken Raiffeisen me nr. Llogarie 0104030780.

Me date 27/12/2012, Prokuroria per Krime te Renda, ne baze te akteve te procedimit penal nr. 27 te vitit 2012, ka regjistruar procedimin pasuror nr.12.

Si rezultat i hetimit pasuror dhe duke pretenduar se ekziston nje rrezik real dhe potencial qe keto shuma monetare te humbasin apo tjetersohen (neni 11/1, pikat “a”dhe “b te ligjit te posaçem nr. 10192 date 03/12/2009, Prokuroria per Krime te Renda kerkon qe shumat monetare te depozituara ne llogarite bankare te mesiperme t’i nenshtrohen procedures se sekuestrimit, pasi ekzistojne te dhena te mjaftueshme te bazuara ne prova se kjo pasuri eshte krijuar gjate periudhes se perfshirjes se te hetuarit O. T. ne veprimtari

kriminale (neni 3/4 te ligjit nr. 10192 date 03.12.2009).

Prokurori pretendoi se i hetuari nuk disponon te ardhura te ligjshme qe te justifikojne vlerat monetare te gjetura ne momentin e arrestimit te tij, por kjo pasuri eshte krijuar si rezultat i aktivitetit te paligjshem te shtetasit O. T. .

Gjykata vlereson si te drejte dhe te bazuar ne ligj kerkesen e Prokurorise per Krime te Renda, e cila duhet te pranohet duke vendosur sekuestrimin e pasurise se shtetasit O. T. sepse:

Shtetasi shqiptar O. T. hetohet per vepren penale te parashikuar nga neni 283/a/2 i Kodit Penal.

Pra nisur nga lloji i vepres per te cilen hetohet dhe ekzistenca e dyshimit te arsyeshem te bazuar tek indicjet se shtetasi O. T. eshte i perfshire ne nje veprimtari kriminale te trafikimit te lendeve narkotike, ai eshte subjekt ndaj pasurive te te cilit zbatohen dispozitat e ligjit **nr. 10192, date 03/12/2009** “Per Parandalimin dhe Goditjen e Krimin te Organizuar dhe Trafikimit Nepermjet Masave Parandaluese Kunder Pasurise”, sipas parashikimit **te nenit 3/1 pika ç** e ketij ligji.

Mbi kete baze, rezulton se akuza ka rregjistruar edhe procedimin pasuror nr. 12 ne daten 27/12/2012, ndaj ketij shtetasi dhe pasi eshte kryer hetimi pasuror kjo çeshtje eshte paraqitur para kesaj gjykate me kerkesen per sekuestrimin e pasurive qe jane verifikuar nga akuza se jane ne pronesi te shtetasit O. T. .

Nga hetimi pasuror i kryer nga policia gjyqesore, sipas parashikimit te nenit 6 te ligjit nr. 10192, akuza pretendon se si rrjedhoje e veprimtarise kriminale, shtetasi O. T. ka fituar mjete financiare ne menyre te paligjshme te cilat i ka patur me vete ne momentin e arrestimit te tij, vlere e te cilave (**prej 10.490 euro dhe 10.600 leke**), haptazi nuk perputhet me te ardhurat ekonomike te verifikuara nga akuza se ka siguruar ky shtetas.

Pra ne baze te provave te paraqitura nga akuza, gjykata vlereson se shtetasi **O. T.** eshte subjekt i ligjit nr. 10192 date 03/12/2009 “**Per parandalimin dhe Goditjen e Krimin te Organizuar dhe Trafikimit Nepermjet Masave Parandaluese kunder Pasurise**” sepse jo vetem qe ka dyshime te arsyeshme te bazuar ne indicje se ai ka kryer nje nga veprat penale te parashikuara ne nenin 3 te ligjit nr.10192, por edhe sepse i jane evidentuar nen posedim vlere monetare, te cilat nuk justifikohen dukshem me te ardhurat e tij.

Gjykata mbi bazen e provave te shqyrtuara vlereson se ekziston nje rrezik real per humbjen e kesaj vlere monetare ne shumen prej 10.490 euro dhe 10.600 leke te cilat jane depozituar ne Banken Intesa San Paolo me nr. Llogarie XXXXXXXXXX dhe ne Banken Raiffeisen me nr. Llogarie XXXXXXXXXX, rrethane kjo e parashikuar nga neni 11/1 pika a e ligjit nr. 10192, date 03/12/2009, prandaj me qellim ruajtjen e saj, eshte e nevojshme vendosja e mases se sekuestrimit.

Meqenese sipas nenit 12 te ligjit nr. 10192, date 03/12/2009, ky gjykim u zhvillua vetem me prezencen e prokurorit, urdherohet sekretaria gjyqesore te njoftoje shtetasin O. T. te cilit i jane gjetur vlerat montare qe sekuestrohen sipas neneve 130 e vijues te K.Pr.Civile, ne adresen e vendndodhjes se tij.

Per ekzekutimin e ketij vendimi, ne perputhje me nenin 14 te ligjit nr. 10192, date 03/12/2009 urdherohet Zyra e Permbarimit Gjyqesor Tirane, ndersa per administrimin dhe perdorimin e llogarive bankare ngarkohet **z. K. XH.**, i cili eshte administrator prane Agjencise per Administrimin e pasurive te Sekuestruara dhe te Konfiskuara prane Ministrise se Financave Tirane.

Meqenese kjo pasuri eshte sekuestruar ne kuader te procedimit penal nr. 27 te vitit 2012, kjo gjykate vlereson se ne baze te nenit 5 te ligjit nr.10192 date 03/12/2009 ***“Per parandalimin dhe Goditjen e Krimet te Organizuar dhe Trafikimit Nepermjet Masave Parandaluese Kunder Pasurise”*** duhet te urdheroje edhe pezullimin e pasojave te zbatimit te mases se sekuestrimit te dhene ne kuader te ketij ligji deri ne dhenien e nje vendimi gjyqesor penal te formes se prere per revokimin apo shuarjen e kesaj mase.

Mbi arsyetimin e pasqyruar me siper ne baze te nenit 212 e vijues te K.Pr.Civile dhe neneve 3/1/d, 3/2/a, 3/4 11, 12, 14 dhe 15 e vijues te ligjit nr. 10192, date 03/12/2009 ***“Per parandalimin dhe Goditjen e Krimet te Organizuar dhe Trafikimit Nepermjet Masave Parandaluese kunder Pasurise”***, kjo gjykate pasi formoi bindjen dhe ne mbeshtetje te provave te shqyrtuara ne kete gjykim:

V E N D O S I

Pranimin e kerkeses duke sekuestruar pasurite e meposhtme te shtetasit O. T. :

1. Shumen prej 10.490 euro te depozituar ne Banken Intesa San Paolo me nr. Llogarie XXXXXXXXXX.
2. Shumen prej 10.600 leke te depozituar ne Banken Raiffeisen me nr. Llogarie XXXXXXXXXX.
3. Pezullimin e pasojave te zbatimit te mases se sekuestros mbi keto vlera monetare derisa te jepet nje vendimi gjyqesor penal i formes se prere per

revokimin ose shuarjen e mases se sekuestros se dhene nga Prokuroria per Krime te Renda me date 31/05/2012 per te njejtat pasuri ne kuder te procedimit penal nr 27 te vitit 2012.

4. Per Administrimin dhe perdorimin e **llogarise bankare** ngarkohet **z.K. Xh.** , i cili eshte administrator prane Agjencise per Administrimin e pasurive te Sekuestruara dhe te Konfiskuara prane Ministrise se Financave Tirane.
5. Per ekzekutimin e ketij vendimi ngarkohet Zyra e Permbarimit - Tirane.
6. Urdherohet sekretaria gjyqesore e kesaj gjykate te dergoje menjehere kopje te ketij vendimi ne institucionet e mesiperme si dhe per njoftimin e zoteruesit te pasurise O. T. , ne adresen e qendrimit te tij.

Kunder ketij vendimi lejohet ankim ne Gjykatën e Apelit per Krime te Renda brenda afatit ligjor.

U shpall sot ne Tirane, me date 29/12/2012, ora 11.00.

Sekretar
Besjan HYSI

Gjyqtare
Iliriana OLLDASHI